

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE- Departamenti për krime të Rënda në Pejë, Kryetari i trupit gjykues – Gjyqtari, Sylë Lokaj, dhe anëtare e trupit gjykues Nushe Kuka-Mekaj dhe Sejdi Blakaj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Binake Mulliqi, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, PP.nr.365/2016 dt.30.01.2017 kundër të akuzuarit V.P. e për shkak të veprës penale blerja , posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.2 e lidhur me nenin 281 par. 1 pika 1.8 të KPK-së. Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ardian Hajdaraj ,të akuzuarit dhe mbrojtësit sipas detyrës zyrtare Av. G.B. nga Peja, me **dt. 28.02.2017** mur dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **V.P.** , i biri i I. dhe nënës L. e gjinisë R, i lindur me në fsh. S të D R. e Shqipërisë ,ku e ka vendbanim të përhershëm , ka të kryer, i gjendjes së ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Shqipërisë , i gjykuar me parë, gjendet në masën e paraburgimit nga **dt.22.12.2016** .

Ë S H T Ë F A J T O R

- Për shkak se :

Më dt. 22.12.2016 në ora 15.00 në Pikën Kufitare Kulla K. Pejë, pa autorizim dhe me qëllim të shitjes ka transportuar dhe dërguar substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë ,në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri me një ngjitës me ngjyrë të verdhë ka mbështjellur 17 (shtatëmbëdhjetë) paketime me narkotikë të llojit “Marihuanë” në peshë prej 16798,65+/-0,0250 gram, të cilat paketime i ka vendosur në një rezervuar të posaçëm të punuar enkas në mes të ulëseve të pasme të automjetit të tij, të llojit “Mercedes-250D” me ngjyre hiri me targa regjistrimi,e ku pastaj me këtë automjet nga Shqipëria ka kaluar Piken Kufitare në Vërmicë dhe me qëllim që ta kalojë kufirin me Malin e Zi, me ç ‘rast kur ka arritur të vendi kritik, gjatë kontrollit dhe bastisjes që i është bërë veturës së tij i është gjetur dhe sekuestruar narkotiku i përshkruar më lartë, ku ka qenë i kamufluar me ngjitës dhe përmbi ka pasur të hedhur specë të kuqe, në mënyrë që të mos e diktojnë qentë e njësisë policore,

-me qka ka kryer veprë penale blerja ,posedimi ,shpërndarja, dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPK-së

Me dt. 22.12.2016 në vendin dhe mënyrën e përshkruar si në diapozitiv të aktgjykimit

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 4, 7, 17 par.1, 21 par.2, 41, 46, 62 par.2 pika 2.7, 69, 73, 374 par.1 të KPK, nenit 365, 366, 453, e lidhur me nenin 233 par.21 , nenit 359, 361, 365, 366, 368 dhe 370 të KPK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

1. Dënim burgimi në kohëzgjatje prej 22 muaj

2. Me dënim me gjobë në shumë prej 1.000,00 € euro,

Dënimin me gjobë i akuzuari është i detyruar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, e nëse dënimi me gjobë nuk e ekzekuton apo e refuzon ekzekutimin, Gjykata të njëjtin dënim do ta zëvendëson me dënim burgimi duke llogaritur 20 € (njëzetë euro), për një (1) ditë burgu.

3. Dënimi plotësues:

-konfiskimi i 16 kg e 798,65 narkotik të llojit marihuana e cila pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi kanë për tu asgjësua.

-Konfiskohet automjeti i markës mercedes me targa AA 393 AI i cili do ti dorëzohet agjencionit për menagjim të sendeve të sekuestruara i cili do të shitet në ankand publik e mjetet e fituara nga shitja do të derdhen në bugjetin e Kosovës.

-konfiskohen paratë në shumë prej 556 ero, 1320 lekë të cilat do të derdhen në bugjetin e Kosovës,

Ndaj të akuzuarit vazhdohet paraburgimi për deri sha aktgjykimi të merr formën e prerë por jo më gjatë se dënimi me burg.

I akuzuari detyrohet që në emër të shpenzimeve të procedurës të ja paguaj shumën prej 100 euro ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, shumën prej 25 €

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merë formën e prerë

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Renda në Pejë, me aktakuzën PP.nr.365/16 dt.30.01.2017,e ka akuzua V.P. për veprë penale blerja , posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.1 te KPK-së,

Në shqyrtim kryesor Prokurori i Shtetit Adrian Hajdaraj ka mbete në tersi pranë aktakuzës, kualifikimit të njëjtë juridik te veprës penale.

I akuzuari V.P që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, në tërësi e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit Av. G. B., ka deklarua se i pandehuri e ka pranuar fajësinë pa presion nga as kush, e pas këshillave të mjaftueshme qe i ka pasur me mbrojtjen, pajtohem me pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Meqenëse i akuzuari që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, në tërësi e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, Prokurori i Shtetit, është pajtuar me pranimin e fajësisë , gjykata është bindur se i akuzuari fajësinë e ka pranua pa presion nga askush e pas këshillave të mjaftueshme nga mbrojtësi, ai e ka kuptua natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, pranimi i fajësisë është i bazuar në provat në shkresa te lëndës, raporti policor i dt. 22.12.2016 dëftesa për

konfiskimin e narkotikut, aktakuza nuk përmban asnjë nga shkeljet e qarta ligjore Për këtë gjykata gjen se janë plotësuar kërkesat e parapara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, ashtu që në kuptim të nenit 248 par.4 të KPPK-së e ka pranua pranimin fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale , blerja , posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.1 te KPK-se.

Meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë, pranimi i fajësisë është i bazuar në provat në shkresat e lëndës, me këtë gjykata vërteton se i akuzuari ditën, kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, e ka kryer veprën penale, blerja , posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve , substancave psiko-tropike dhe analoge nga neni 273 par.1 te KPK-se. Për këtë gjykata të akuzuarin e ka shpallë fajtor dhe penalisht përgjegjës.

Para se të vendoset mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese të cilat kishin për të ndikua në llojin dhe lartësinë e dënimit. Rrethana rënduese gjykata ka gjet se i akuzuari është recidivist. Ndërsa si rrethana lehtësuese janë marrë sjellja e të akuzuarit pas kryerjes se veprës penale- bashkëpunimi me organet e ndjekjes, gjendja tejet e dobët ekonomike, fakti se është mbajtës i vetëm i familjes, e posaçërisht faktin se i akuzuari që në fillim të shqyrtimit gjyqësor në tërësi e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Duke marrë parasysh këto rrethana gjykata të akuzuarin e ka gjykuar me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 22 muaj, dhe dënim gjobë në shumë prej 1000 euro, si dhe dënim plotësues , konfiskimi i narkotikëve i cili ka qenë objekt në kryerjen e veprës penale.

Kështu është vendosë me bindje të thellë se edhe një dënim i tillë i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, dhe se i njëjti dënim do të ndikoj dukshëm ne sjelljet e të akuzuarit në të ardhmen , me çka do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 te KPK-së.

Vendimi që i akuzuari të ja kompensoj gjykatës shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 450 par. 2 pika 2 dhe 6 te KPPK-së, me bindje se i akuzuari i ka kushtet për përmbarrim.

Nga sa u tha me lartë, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

U VENDOS NE GJYKATEN THEMELORE – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA NË PEJË, me dt.28.02.2017

P.nr.11/2017

Sekretarja Juridike
Binake Mulliqi

Kryetari i Trupit Gjyqësor - Gjyqtari
Sylë Lokaj

UDHZIM JURIDIK

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditësh , pas marrjes, Gjykatës së Apelit ne Prishtinë e përmes kësaj Gjykate.